



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1578 prot.

Tiranë, më 16.11.2021

V E N D I M

Nr. 219, Datë 16.11.2021

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja b), dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën nr. 111, datë 14.06.2021, të paraqitur nga Qendra “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri³”, kundër: B.T, gazetarë pranë Radio Televizionit Shqiptar, me pretendimin për diskriminim, në formën e gjuhës së urrejtjes, për shkak të “orientimit seksual”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: “Gazetarja B.T, në emisionin ABC e Pasdites⁴, të datës 08.06.2021, ka përdorur gjuhë diskriminuese, duke deklaruar se XH.K e “degeneron shoqërinë”, “nuk bën dot familje” dhe “është fatkeqësi të ketë fëmijë”. Prononcimi dhe artikulimi publik në këtë rast përbën diskriminim në kuptim të nenin 3 të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, pasi subjekti në fjalë që merr pjesë në jetën publike, mes daljeve publike periodike, mes prononcimeve dhe thirrjeve të tilla, ka të gjitha mundësitë të ketë krijuar dhe/ose të krijojë në të ardhmen baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Përfaqësuar pranë KMD-së nga S.Z, Drejtore Ekzekutive e Qendrës.

⁴ https://www.youtube.com/watch?v=sxgQh_27JGw

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shqyrtimin e ankesës dhe kërkimin e ndjesës publike nga subjekti kundër të cilit është bërë ankesa.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/b të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankesë, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:

b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Në pikën 1, të nenit 128, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, gjithashtu parashikohet koncepti i legjitimitetit edhe kur pala legjitimohet për të nisur një procedim administrativ. Sipas këtij neni, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj të ligjshëm cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Në rast se do t’i referohemi LMD-së, rezulton se në nenin 32, pika 1, germa b) të tij parashikohet shprehimisht se:

“1. Komisioneri ka kompetencë:

b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtëpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3/11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “‘Organizatata me interesa legjitime’ janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit”.

Nga aktet e administruara rezulton se, Qendra “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri” është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 722, datë 01.03.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Qendra “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave që i përkasin komunitetit LGBTI, nga prononcimet dhe artikulimi publik, nga ana e gazetares B.T.

Nëse do t’i referohemi Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilit Qendra “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri” është regjistruar si person juridik, konstatohet se objekti kryesor i veprimtarisë së kësaj shoqate është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive të komunitetit LGBT në Shqipëri. Mbështetur në përmbajtjen e Aktit të Themelimit, rezulton se forma e organizatës jofitimrurëse, është ajo e Qendrës, parashikuar në

ligjn nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurese”, dhe objekti kryesor i veprimtarisë së Qendrës është si më poshtë:

- Mbrojtja proaktive e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri;
- Promovimi i dinjitetit, barazisë dhe të drejtave të personave LGBT në Shqipëri;
- Lufta kundër diskriminimit të bazuar tek orientimi seksual dhe identiteti gjinor;
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë dhe institucioneve për të drejtat e personave LGBT;
- Përmirësimi i politikave dhe ligjeve në favor të komunitetit LGBT në Shqipëri, etj.

Në këtë kontekst, theksojmë faktin se në bazë të pikës 1, të nenit 4, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në objektin e veprimtarisë së Qendrës “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri”, (në vijim, Qendra) sipërcituar në vendim, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së palës ankuese dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se pala ankuese legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Mbështetur në përmbajtjen e emisionit “ABC e Pasdites⁵”, transmetuar në televizionin ABC News, në datë 08.06.2021, rezulton se kanë qenë të ftuara: Xh.K, B.T dhe M. L, të cilat kanë diskutuar dhe debatuar në lidhje me evoluimin e konceptit të familjes me ekzistencën e realitetit të ri, atë të krijimit të çifteve/familjeve nga komuniteti LGBT, si dhe mundësinë e zëvendësimit të fjalës “nënë” me “prindi që ka lindur” ose “prindi 1” dhe “prindi 2”.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 111, datë 14.06.2021 të Qendrës “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri”, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 910/2, datë 28.06.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime lidhur me gjuhën e përdorur në emisionin “ABC e Pasdites” të datës 08.06.2021, transmetuar në televizionin ABC News, nga B.T për ankesën e bërë nga Qendra “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri”.
- Në vijim, B.T iu drejtuar Komisionerit me e-mailin datë 07.07.2021, nëpërmjet së cilit dërgoi shkresën me lëndë “Kërkesë paraprake procedurale”, ku kërkon informacion dhe sqarime të mëtejshme, lidhur me ankesën e depozituar kundër saj.

⁵ <https://www.youtube.com/watch?v=tI4pdwUm-9M>

- Me shkresën nr. 910/3, datë 09.07.2021, drejtuar B.T, Komisioneri e sqaron, lidhur me paqartësitë e parashtruara si dhe i dërgon bashkëlidhur kopje të ankesës së depozituar nga ana e Qendrës “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri”.

Me shkresën datë 13.07.2021, B.T në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Citimi, transkriptimi i tekstit të ankueses është jashtë kontekstit të thënë nga unë dhe për pasojë krejt i deformuar dhe pa asnjë lidhje me debatin real që ka ndodhur në studion e TV ABC. Në emisionin “ABC e Pasdites” (08.06.2021) XH.K e ftuar si përfaqësuese e OJF-ve të LGBTQ+ ka deklaruar se: - Duhet zëvendësuar nocioni NËNË dhe BABA me Prindi 1 dhe Prindi 2, në regjistrimin e fëmijëve në dokumentacionin ligjor të identitetit dhe origjinës si dhe përcaktimet ligjore sepse familjet homoseksuale nuk i regjistrojnë dot fëmijët e tyre me 2 nëna dhe 2 baballarë dhe as të dy si prindër biologjikë. - Familjet heteroseksuale janë baza e problemeve sociale. - Familjet heteroseksuale lindin shumë dhe kjo ka sjellë mbipopullimin e planetit duke u bërë një problem për vetë planetin. - Familjet me 2 burra mund të lindin fëmijë nëpërmjet nënave surrogato. Pikërisht për shkak të këtyre deklaratave është krijuar edhe një reaksion publik ndaj shpalosjes së këtyre qëndrimeve nga ana e Znj. XH.K por kjo s'do të thotë që për të mbuluar hallet që i ka shkaktuar XH.K vetes dhe aktivistëve të tjerë të komunitetit LGBTQ+ të kërkohet një kokë turku për të gjetur një fajtor që nuk është. Në lidhje me perifrashimet e shkëputura nga konteksti si “XH.K e “degjeneron shoqërinë”, “nuk bën dot familje” dhe “është fatkeqësi të ketë fëmijë”: - deklaroj me përgjegjësi të plotë se këto janë fjalë pa asnjë kuptim kështu të prera dhe të shkëputura nga konteksti i debatit dhe janë bashkuar qëllimisht për të deformuar të vërtetën. - Deklarata ime se “XH.K e degjeneron shoqërinë” nuk lidhet aspak me orientimin e saj seksual në përgjithësi apo veçanti por me sjelljen e saj përgjatë debatit, një sjellje krejt harbute, fyese, tallëse, sharëse ku unë e kam theksuar në mënyrë eksplicite se ajo është krejt e paedukatë dhe mungesa e saj e etikës minimaliste në komunikim me shprehje të tilla si: “Familjet heteroseksuale janë baza e të gjithë problemeve sociale”, “Ju familjet heteroseksuale lindni kaq shumë sa kjo ka sjellë mbipopullimin e planetit duke u bërë problem për vetë planetin”, “kjo është injorancë kaq e madhe dhe s'më ka rastisur në një emision që të debatoj me një grua të moshës tate kaq injorante”.... kanë marrë përgjigjen e merituar 100%, sepse unë i jam drejtuar XH.K si person, si individ i paedukatë dhe ofendues dhe jo XH.K si lesbike që është “degjenerim për shoqërinë sepse ti nuk ke pikën e edukatës, do rrisësh ti fëmijë, inshallah e bën një fëmijë dhe e rrit por me këtë edukatë është fatkeqësi që ti të rrisësh një fëmijë”. Ngatërrimi i qëllimtë, deformues, manipulues dhe thjesht hakmarrës i XH.K duke ngatërruar identitetin e saj gjinor me identitetin e saj si një individ i paedukatë, bullist, ofendues, madje edhe diskriminues ndaj nënave dhe personave heteroseksual sqarohet menjëherë dhe për këdo mjafton të shohë videon që është zhdukur, pasi XH.K ka mohuar ato që ka thënë live dhe që shumë njerëz i kanë parë dhe janë gati të dëshmojnë për atë që kanë parë. Nëse dikë e gënjen mendja se unë duhet ti kursej XH.K si individ përgjigjen e merituar pas ofendimeve dhe sulmeve të vazhdueshme karshi meje si gazetares, si nënë, si grua, sepse ajo abuzon me identitetin e saj gjinor, ta harrojë sepse askush nuk e ka luksin që në një rast të tillë unë do të hesht për të mbrojtur dinjitetin me të

drejta të barabarta me këdo që vjen në një debat. Çdo fjalë e cituar nga XH.K është e shkëputur qëllimisht nga konteksti për të shpikur adresimin te orientimi i saj seksual dhe jo ashtu siç ka qenë në të vërtetë si adresim ndaj personalitetit të keq bullist ndaj nënave dhe familjeve tradicionale i një personi që s'ka absolutisht asnjë rëndësi nëse është lesbike apo heteroseksuale por thjesht bulizon këdo që nuk i shkon sipas fluturimeve të saja që kërkon të heqë emrin NËNË dhe BABA për ti zëvendësuar me PRINDI 1 dhe PRINDI 2 nga dokumentacioni ligjor i çdo fëmije dhe prindi, apo që hedh baltë mbi shëndetin e familjes tradicionale madje i akuzon ato si problemi më i madh i planetit për shkak se linden kaq shumë, përfshirë dhe mua. - Referuar Nenit 3, 10/2/6, 17/2, 18/1/2, 22/1, 23/1, 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Nenit 9 dhe 10 të KEDNJ-së, sqaroj se çdo qëndrim është në kuadër të lirisë së fjalës, dhe në kuadër të lirisë së ndërgjegjes të cilat janë të garantuara. Unë gjithmonë kam deklaruar se çdo kush ka të drejtën të jetojë jetën e tij dhe askush nuk mund të diskriminohet për këtë shkak, dhe përgjatë emisionit unë shprehem qartë se unë nuk kam asgjë absolutisht kundër me të drejtën e lesbikeve dhe gay-ve për tu martuar, madje jam dakort që edhe të martohen, por kam bindjet e mia konservatore dhe si nënë, që adoptimi i fëmijëve nga ata është në kundërshtim me moralin dhe ligjin (kujoj se në legjislacionin shqiptar nuk favorizohet (ndalohet) adoptimi i fëmijëve nga një kategori e caktuar personash si ata që nuk kanë mundësi financiare për ti mbajtur, janë në moshë të thyer, kanë pengesa shëndetësore, nuk kanë mundësi ti ofrojnë fëmijës role të shëndetshme prindërore, abuzojnë me alkolin, kanë precedent kriminalë, etj, por në asnjë rast këto nuk konsiderohen si diskriminime apo fobi ndaj kategorive apo komuniteteve të caktuara shoqërore. E kam gabim apo e kam drejtë, kjo është bindja ime dhe askush s'ka të drejtë të më gjykojë për të shprehur e lirë si gazetarë dhe si nënë dhe pa kufizime bindjet e mia në mbrojtje të familjes, fëmijëve, nënave dhe baballarëve. Siç vërtetohet nga i gjithë emisioni i fshirë nga TV ABC dhe youtube, asgjë që kam thënë nuk ka patur dhe nuk ka qëllim të nxisë urrejtje ndaj një komuniteti për më tepër nuk kam bërë as thirrje të tilla por përkundrazi nuk urrej askënd dhe dëshiroj që të gjithë të jetojnë së bashku paqësisht”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 111, datë 14.06.2021, Komisioneri me shkresën nr. 1212, datë 20.08.2021, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 07.09.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces.
- Për shkak të pamundësisë së përfaqësimit të palës ankuese në datë 07.09.2021, Komisioneri me shkresën nr. 1299, datë 15.09.2021, njoftoi palët për shtyrjen e zhvillimit të seancës dëgjimore, për në datë 23.09.2021.
- Për shkak të mosparaqitjes së palës ankuese dhe pamundësisë së marrjes pjesë të palës ndaj të cilës drejtohej ankimi, Komisioneri me shkresën nr. 1299/1, datë 06.10.2021, njoftoi palët për shtyrjen e zhvillimit të seancës dëgjimore, për në datë 13.10.2021.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: përfaqësueses të subjektit ankues⁶ dhe B.T.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Përfaqësuesja e subjektit ankues⁷ në parashtrimet e saj, në mes të tjerash, deklaroi se: *“Në qëndrimin publik të gazetares B.T është përdorur gjuhë e njëanshme diskriminuese ndaj përfaqësueses së Aleancës LGBTI dhe anëtarëve të komunitetit LGBTI. Deklaratat e B.T, përveçse një rast diskriminimi, i konsiderojmë edhe si rast të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, ku mes shprehjes në publik, çka i jep në mënyrë faktike një pozicion nxitës të opinionit shoqëror, ka të gjitha gjasat të ketë nxitur denigrimin dhe urrejtje ndaj komunitetit LGBTI+ dhe fëmijëve të lindur nga ky komunitet, ka fyer, stereotipizuar negativisht, si dhe ka nxitur stigmatizim. Gazetarja B.T në të njëjtin emision është shprehur se XH.K, e cila ishte ftuar në emision si përfaqësuese e komunitetit LGBTI+ dhe për pasojë asociohet nga publiku me komunitetin në fjalë, por dhe ata si XH.K degjenerojnë shoqërinë, nuk bëjnë dot familje dhe është fatkeqësi të kenë fëmijë. Në këtë linjë, nxjerrja nga konteksti e deklaratave është e pamundur, pasi qëndrimi publik i gazetarës është i qartë edhe në statuset e saj publike në rrjetet sociale, ku keqinformon publikun se komuniteti LGBTI+ synon heqjen e nocioneve nënë dhe baba dhe deklarohet si mbështetëse e familjes që e quan tradicionale, duke pozicionuar indirekt anëtarët e komunitetit LGBTI+, si kundërshtarë të familjes dhe të nocioneve nënë dhe baba”.*

Gjatë seancës dëgjimore, B.T, deklaroi⁸ se: *“Kam qenë e ftuar në emision si individ dhe jo si përfaqësuese e gazetarëve dhe komentet në facebook janë qëndrimet të mia individuale. Komunitetin LGBT nuk e shoh as të përjashtuar, as si komunitet që kërkon mbështetje ekstra, por e shoh si një pjesë të shoqërisë që në kushtet private të jetës, zhvillon aktivitetin e vet që nuk cënon as jetën publike. Unë nuk jam paragjyquese e diskriminuese ndaj këtij komuniteti..... Ndofta përgjigja ndaj XH.K, si individ mund të ishte shmangur në atë ton, por ishte përgjigje e mënyrës se si XH.K mu drejtua, se si më bullizoi, fyeu në të gjitha mënyrat.....Unë nuk mund të pranoj, që dikush të më drejtohet si grua, si nënë apo gazetarë, që unë lind sa për të gjithë aq sa mbipopulloj botën dhe që ishte injorante. Unë kam këmbëngulur që dy baballarë nuk lindin dot dhe nuk ka asgjë diskriminuese, por unë si individ mendoj që familja ime dhe fëmijës tim të ishte mes nënës dhe babait”.*

⁶ Bordi Drejtues i Qendrës “Të Bashkuar Pro Kauzës LGBT në Shqipëri”, me Vendimin nr. 6, datë 06.08.2021, ka zgjedhur znj. A.A, si Drejtore Ekzekutive të qendrës.

⁷ Znj. D.N, përfaqësuese me autorizimin datë 12.10.2021.

⁸ Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 14.30 e në vijim.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje për të cilat janë ngritur pretendimet në ankesë, dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Sipas informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit, u konstatua që:

Në datë 08.06.2021, në emisionin ABC e Pasdites⁹, është zhvilluar debati me temë: *“Zëvendësimi i termit nënë, baba me prindi parë, prindi dytë, dhe si koncepti i familjes po ndryshon. A është koha në Shqipëri për të ndryshuar legjislacioni”*. Emisioni ka zgjatur rreth 38 minuta, dhe të ftuar kanë qenë: B.T, M.L dhe XH.K. Gjatë këtij emisioni, në mes të tjerash, të ftuarit kanë shprehur opinionet e tyre si më poshtë:

Min. 05.24: B.T: Jam e hapur për të diskutuar, për të vënë fjalën, prindi 1, prindi 2, nuk mund të zëvendësohet fjala nënë.

Min. 09.35: B.T: Deri te prindi nr. 1 dhe nr. 2 për të mos cënuar të drejtën, pavarësisht mendimit tim personal që jam kundër ndërtimit të familjes në këtë formë, është temë delikate dhe do diskutim të gjatë..... deri këtu është më e pranueshme prindi nr.1

Min. 18.20: B.T: Po, në ecurinë e shoqërisë, në modelin e familjes, jam tradicionale, s’heq dot dorë nga kjo gjë.

Min. 18.59: XH.K: Për aq kohë sa je familje, ne insistojmë që të jemi familje me të drejta të barabarta, sepse i bie që njëra nga partneret të mos ketë asnjë të drejtë tek fëmijët dhe në rast se ndodh diçka, fëmija mbetet jetim, ndërkohë që fëmija ka dhe prindin tjetër, që ka kaluar vitet e jetës, duke e rritur dhe përkujdesur....

Min. 19.32: B.T: Unë personalisht jam absolutisht shumë pro dhe e gatshme të mbështes komunitetin LGBT që të kenë një martesë, por jam kundër që ato të kenë një familje, sepse më duket sikur merr fund familja, nuk zhvillohet një familje.... të kenë kurorëzim ligjor, të mos adoptojnë dot një fëmijë....

Min. 22.48: B.T: Dy prindër baballarë i japin fund familjes.. sepse nuk lindin dot, aty mbyllet cikli..... pse duhet të adoptojnë.....

Min. 23.15 e në vijim: B.T: Nuk mund të krahasohet një familje heteroseksuale që për një arsye shëndetësore, fizike, nuk bëjnë fëmijë, me dy baballarë që kanë vendosur ti japin fund, nuk janë njësoj....

XH.K: A japin kontribut në shoqëri njëloj, a janë anëtarë të respektueshëm njëloj....

⁹ https://www.youtube.com/watch?v=sxgQh_27JGw

B.T: Merr fund jeta...

XH.K: Mua më vjen keq se je grua dhe ke këtë koncept...

B.T: Sigurisht jam grua dhe nënë...

XH.K: I vetmi pozicion që i jep gruas, është pozicioni riprodhues...

B.T: Ashtu do ta kuptosh ti, unë gruas i jap pozicionin edhe për edukim familjar...

XH.K: Kështu funksionon jeta...

B.T: Nuk funksionon jeta me dy baballarë që duan ti japin ecuri jetës dhe nuk lindin dot, merr fund jeta me një familje homoseksuale...

Min. 24.04 e në vijim: XH.K: Edhe nëse nuk lindin çiftet homoseksuale, mjaftoni lindni ju të tjetët aq shumë sa është mbipopulluar bota...

B.T: Kjo është fyese, kjo dalim tek termi nëna që lind, dmth prindi që lind, kjo është fyese kjo që thotë, lindni juve sa për të gjithë..... Është fyese, ti më fyen mua si grua, si individ dhe si nënë...

XH.K: Unë nuk e shoh gruan si ato gra që nuk mund të lindin nuk janë të barabarta...

B.T: Është fatkeqësi për ato që nuk mund të lindin, është zgjedhje për ju, ju nuk bëni dot familje...

Min. 24.50: XH.K: Unë mund të bëj familje, unë dhe partnerja ime që nesër mund të lindim nëse duam...

B.T: Dy burra nuk lindin dot, i japin fund...

Min. 25.35: B.T: Një familje heteroseksuale në konceptin tim që nuk ndryshon dot, ashtu sikurse unë nuk ndërhyj dot në konceptin tënd...

XH.K: Në konceptin tënd...

B.T: Ti thjesh po më fyen mua dhe të gjithë ato si unë, që lindin.

XH.K: Unë thashë që ti fyen të gjitha ato gra që zgjedhin të mos lindin ose që nuk lindin dot, sepse ti e sheh gruan në pozicionin riprodhues...

B.T: Kam 20 vjet në karrierë, nuk shikoj rolin e gruas ashtu si thua ti, ti po e merr fjalën time dhe po e kthen si të duash ti, si zakonisht... është mendimi im, një familje homoseksuale i jep fund shoqërisë...

Min. 30.00: XH.K: Kjo është injorancë e madhe, po më habit, është injorancë llahtaritëse, unë nuk e di në jetën time kam shumë debate, por të jem me një grua të moshës tënde, kaq injorante...më llaftaris shumë...

B.T: Kjo e imja është injorancë

Moderatori i emisionit: Të mos kalojmë në ofeza personale.....

XH.K: Kjo po më ofendon mua.... po më thua se nuk je familje me partneren tënde.....

Min. 30.25: B.T: Nuk po të ofendoj, për ç'farë po të ofendoj, ky është rrisku që të rrisësh një fëmijë të...ja pra se ti e degjeneron shoqërinë, ky është rrisku, ti s'ke pikën e edukatës do rrisësh ti një fëmijë, ti ishalla e bën fëmijën dhe e rrit, por është fatkeqësi e madhe, që ju të rrisni një fëmijë...

Për sa më sipër, sikurse rezulton edhe nga biseda e zbardhur në kontekstin origjinal, mes të ftuarve është diskutuar mbi këtë realitet të ri të krijuar në shoqëri, faktin që tashmë zëvendësimi i fjalës nënë është bërë realitet dhe aplikohet në rreth 27 vendet të ndryshme të botës, si dhe kanë shprehur opinionet e tyre mbi konceptin e familjes. Në vijim të bisedës, B.T është shprehur se është e hapur për të diskutuar rreth përdorimit të termit prindi 1 dhe prindi 2, por në pikëpamjen e saj, është kundër familjes homoseksuale, pasi mendon se familja tradicionale mes një burri dhe një gruaje, është familja e duhur. Gjatë zhvillimit të debatit, B.T i është drejtuar personalisht, znj. XH.K, duke i thënë: ..ti e degjeneron shoqërinë.....ti s'ke pikën e edukatës do rrisësh ti një fëmijë, etj.

Në mbyllje të emisionit, drejtuesi i emisionit është shprehur se, trajtimi i një teme të tillë ishte domosdoshmëri dhe në përshtatje me realitetin e ri të krijuar, dhe që diskutimet kanë qenë shprehje dhe shkëmbim i opinioneve personale të pjesëmarrësve në emision.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, realizimi dhe transmetimi i emisioneve të tilla televizive dhe jo vetëm, është në funksion të qëllimeve dhe detyrës së vetë medias, me synim sensibilizimin e opinionit publik lidhur me evoluimin e konceptit të familjes në shoqëri, (krijimin e çifteve LGBT në botë dhe në Shqipëri), si dhe me nevojën për ndryshime në legjislacionin përkatës, në përshtatje me këtë realitet të ri.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike.

Dinjteti i njeriut dhe të drejtat dhe liritë e tij, janë në bazat e shtetit shqiptar. Kjo sanksionohet në nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet se: *“Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë”*.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të

gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Barazia përpara ligjit është një parim kushtetues i sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹⁰.

Liria e shprehjes dhe mendimit, toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore, është thelbësore për një shoqëri demokratike dhe pluraliste. Megjithatë, liria e shprehjes dhe mendimit nuk është një e drejtë e pakufizuar dhe se ajo nuk duhet të ushtrohet në një mënyrë të papajtueshme me të drejtat e të tjerëve.

Në shoqëritë multikulturore, të cilat karakterizohen nga shumëllojshmëri traditash, besimesh fetare dhe mënyrash jetese, ndonjëherë është e nevojshme që e drejta për lirinë e shprehjes të ekuilibrohet me të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ose të drejtën për të qenë i mbrojtur nga diskriminimi. Arritja e kësaj mbrojtjeje, bëhet përmes balancës mes tyre, pasi këto të drejta përbëjnë shtyllat themelore të një “shoqërie demokratike”.

Liria e shprehjes, është një e drejtë Kushtetuese, e cila garantohet nga neni 22/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹¹. Kushtetuta sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹².

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila në nenin 14¹³, garanton parimin e barazisë dhe detyron shtetet anëtare që të garantojnë gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë pa diskriminim, si dhe Protokollin Nr. 12 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të

¹⁰ Neni 18 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive*”.

¹¹ Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Liria e shprehjes është e garantuar*”.

¹² Neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “*Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.

¹³ Neni 14, KEDNJ-së - Ndalimi i diskriminimit “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*”.

Njeriut dhe Lirive Themelore, i cili i detyron shtetet anëtare të garantojnë gëzimin e të drejtave pa diskriminim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të tij, pra edhe për shkak të *orientimit seksual* dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 3/2, të LMD-së, sanksionohet se një person apo grup personash diskriminohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, kur trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

LMD, në nenin 3/8 e tij, ka përcaktuar se, “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Po ashtu, në pikën 13, të po këtij neni, ka përkufizuar “*Shqetësimin*” si formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e mbrojtura, i cili ka për qëllim apo efekt çënimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor të përshtatshëm për të trajtuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për ndalimin e diskriminimit. Si anëtare e Këshillit të Evropës dhe shtet kandidat në Bashkimin Evropian, Shqipëria është pjesë e akteve ndërkombëtare përkatëse. Shqipëria ka përmirësuar shpesh legjislacionin me synim harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian. Legjislacioni aktual vlerësohet se është në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi gjuhën e urrejtjes.

Për këtë arsye, në analizimin që i është bërë opinioneve të shprehura nga B.T gjatë emisionit “ABC e pasdites”, të datës 08.06.2021, në kontekst të pretendimit për përdorinim e gjuhës së urrejtjes dhe nëse do të konsiderohet në tejkalim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, i jemi referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimin të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës¹⁴, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të cenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjokat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

Liria për të pasur një opinion është kusht paraprak i lirive të tjera të garantuara nga neni 10 i KEDNJ-së, dhe gëzon mbrojtje, në kuptimin që kufizimet e mundshme të përcaktuara në paragrafin 2 janë të pazbatueshme. Siç thuhet nga Komiteti i Ministrave, *“çdo kufizim për këtë të drejtë do të jetë në kundërshtim me natyrën e një shoqërie demokratike”¹⁵.*

Shtetet nuk duhet të përpiqen të indoktrinojnë qytetarët e tyre dhe nuk duhet të lejohen të bëjnë dallimin mes individëve që kanë opinione të ndryshme. Për më tepër, promovimi i informacionit të njëanshëm nga shteti mund të përbëjë një pengesë serioze dhe të papranueshme për lirinë për të mbajtur një opinion. Sipas lirisë për të mbajtur një opinion, individët mbrohen edhe nga pasojat e mundshme negative në rastet kur atyre u atribuohen opinione të veçanta pas shprehjeve të mëparshme publike. Liria për të mbajtur opinione përfshin “lirinë negative” për të mos qenë i detyruar për të komunikuar opinionet e veta¹⁶.

Shteti shqiptar është angazhuar për të marrë masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, duke formalizuar vullnetin e tij përmes nënshkrimit të Rekomandimit CM/Rec (2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës *“Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”*, miratuar në datë 31.03.2010. Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të të drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të tyre.

Në kuadër të garantimit të kësaj të drejte, rekomandohet që: *“Shtetet anëtare të marrin masat e nevojshme për të luftuar të gjitha format e shprehjes, të cilat mund të kuptohen në mënyrë të*

¹⁴ 10.2. *“Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.*

¹⁵ Report of the Committee of Ministers, in “Theory and Practice of the European Convention on Human Rights”, P. Van Dijk and G. Van Hoof, Kluwer, 1990, p. 413. (përkthim i Komisionerit)

¹⁶ Vogt v. Germany, 26 September 1995. (përkthim i Komisionerit)

arsyeshme se prodhojnë efektin e nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transeksualëve, duke përfshirë median dhe internetin. “Fjalimet e urrejtjes” ndalohen dhe dënohen publikisht. Të gjitha masat respektojnë të drejtën themelore për lirinë e shprehjes, në përputhje me nenin 10 të Konventës dhe jurisprudencën e Gjykatës”.

Pra, shohim se “fjalimet e urrejtjes” kundër personave të komunitetit LGBT, kanë të bëjnë me të gjitha format e shprehjes, të përhapura si nëpërmjet medias, të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtje, diskriminim apo armiqësi ndaj personave LGBT. Vlerësimi nëse shprehje të tilla apo deklarata të caktuara do të konsiderohen si “fjalime të urrejtjes”, duhet të bëhen në përputhje me lirinë e shprehjes të garantuar në nenin 10 të Konventës.

Gjuha e urrejtjes për qëllim të Rekomandimit CRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes – si psh, mbrojtja, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin raca, ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, mosha, paafërsia, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual¹⁷.

Në vlerësim të Komisionerit, synimi i B.T nuk ka qenë diskriminimi dhe përhapja e urrejtjes ndaj komunitetit LGBT, por ka shprehur qëndrimin dhe bindjet e saja kur është shprehur se: “.....në ecurinë e shoqërisë, në modelin e familjes, jam tradicionale..... një familje homoseksuale i jep fund shoqërisë”.

Referuar deklaratës së bërë në emision, shikohet që ka pasur një acarim momental nga fjalët e shkëmbyera mes palëve, në të cilën u përdorën shprehje jo etike, gjë që çoi në shprehjen e opinionit nga ana e B.T duke u kthyer më shumë në një debat personal. Komisioneri vlerëson se opinionet e shprehura dhe shprehjet e përdorura duhen interpretuar në mënyrë integrale, dmth në të gjithë tërësinë e saj dhe në dinamikë gjatë gjithë emisionit.

Në çështjen Handyside v. Mbretërisë së Bashkuar¹⁸, Gjykata bën një dallim mes një nxitjeje serioze për urrejtje apo stigmatizim dhe të drejtës së individëve për të shprehur këndvështrimin në mënyrë të lirë. Gjatë arsyetimit të vendimit Gjykata është shprehur se: “në funksionet e veta mbikëqyrëse e detyrojnë atë t’i kushtojë vëmendje të madhe, parimeve që karakterizojnë një “shoqëri demokratike”. Liria e shprehjes përbën një nga themelet bazë të një shoqërie të tillë, një nga kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu.

Një zhvillim i fundit pozitiv në lidhje me vetë-rregullimin e mediave në internet është miratimi i Kodit të Etikës së Gazetarit¹⁹. Kodi i Etikës së Gazetarit është hartuar nga ekspertë kombëtarë

¹⁷ Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI(2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

¹⁸ Handyside v. United Kingdom (application no. 5493/72, datë 07.12.1976.

¹⁹ Kodi i Etikës së Gazetarit (2018) i disponueshëm në <https://kshm.al/en/about-us/code-of-ethics/>, (30.4.2020).

dhe ndërkombëtarë (përfshirë gazetarët) në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore për Lirinë e Shprehjes dhe Mediave në Evropën Juglindore” (JUFREX).

Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë, të njohura dhe të pranuar gjerësisht nga mediat dhe organizatat e gazetarëve në vendet demokratike. Ato përbëjnë gurin e themelit të pluralizmit demokratik dhe po ashtu respektojnë frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kodi i Etikës së Gazetarit, në pikën 2, ka shprehur se, është e një rëndësie thelbësore që, media të bëjë dallimin mes faktit dhe opinionit. Media duhet të bëjë qartë dallimin midis opinionit dhe raportimit mbi bazë faktesh. Opinionistët, karikaturistët dhe kritikët janë të lirë të shprehin opinionet e tyre për ngjarje dhe persona. Lajmi lidhet me informacionin e mbështetur nga fakte dhe të dhëna, ndërsa opinionit përmban dhe shpreh ide, gjykime dhe vlerësime të gazetarëve, redaktorëve dhe botuesve.

Në kontekst të sa më sipër, Kodi i Etikës është një instrument vetë-rregullues i cili synon të drejtojë, forcojë dhe përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së gazetarëve në Shqipëri. Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë dhe respektojnë frymën e Kushtetutës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në çështjen Lingens kundër Austrisë²⁰, Gjykata është shprehur se, duke qenë se liria që po diskutojmë i referohet dhënies si të informacionit edhe të ideve, bëhet i rëndësishëm dallimi që ka përcaktuar Gjykata në këtë fazë të hershme. Duke bërë një dallim të qartë midis informacionit (fakteve) dhe mendimeve (gjykimet mbi vlerat), Gjykata është shprehur se: “ekzistenca e fakteve mund të demonstron, kurse e vërteta e vlerave nuk është e prekshme si provë....Në lidhje me gjykimet mbi vlerat kjo kërkesë është e pamundur të përmbushet dhe dhunon vetë lirinë e mendimit, e cila është një pjesë themelore e të drejtës së sigurt nga neni 10 i Konventës”.

Në çështjen Dalban kundër Rumanisë²¹, Gjykata është shprehur se: “Do të ishte e papranueshme për një gazetar që t’i hiqet e drejta për të shprehur gjykime subjektive kritike, përderisa ai ose ajo do të mund ta vërtetojë të vërtetën që thotë”. Si rrjedhojë, bashkë me informacionin ose të dhënat që mund të verifikohen, mendimet, kritikën ose spekulimin që mund të mos provohen si të vërteta, gjithashtu mbrohen nga Neni 10.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se debati i shëndoshë e i hapur në një shoqëri pluraliste nuk mund të arrihet pa ruajtje të fortë dhe të gjithanshme të së drejtës së lirisë së shprehjes. Sipas standardeve përkatëse të Këshillit të Evropës, edhe kufizimet nga e drejta synojnë ti shërbejnë interesit më të mirë të një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Qasja e traktateve përkatëse, kërkon të krijojë hapësirë për një angazhim kritik dhe për debat ndërmjet grupeve me

²⁰ Application no. 9815/82, datë 08.07.1986.

²¹ Application no. 28114/95, datë 28.09.1999.

qëndrime të ndryshme dhe të pozicionuara ndryshe në shoqëri, dhe të sigurojë në të njëjtën kohë se hapësira mbetet tolerante dhe nuk ndikohet nga urrejtja.

Për sa më sipër, liria e shprehjes dhe mendimit mund t'i nënshtrohen vetëm atyre kufizimeve që përcaktohen me ligj dhe janë të nevojshme për të mbrojtur sigurinë, rendin, shëndetin ose moralin publik ose të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se opinionet e shprehura nga B.T kanë qenë shprehje emocionale të drejtuara kundrejt personit në debat dhe nuk kanë pasur për qëllim cenimin apo gjuhën e urrejtjes kundrejt komunitetit LGBTI.

Në konkluzion të analizimit të gjithë sa më sipër në vendim, Komisioneri vlerëson se, nuk evidentohet se shprehjet e deklaruara nga B.T në këtë emision, të ketë të promovuar apo nxitur urrejtje ndaj personave që i përkasin komunitetit LGBT, as në mënyrë të drejtëpërdrejtë, as në mënyrë të nënkuptuar, pasi e ftuara në fjalë ka shprehur mendimin dhe opinionin e saj, lidhur me temën e debatit dhe duke ju drejtuar personalisht pjesëtarëve në debat.

Komisioneri vëren se gjatë debatit të zhvilluar, dy të pranishmet në studio, XH.K dhe B.T, kanë etiketuar njëra tjetrën me konsiderata personale, në vijim të një momenti nervozizmi, por nuk evidentohet se B.T ka dashur të nxisë urrejtje ndaj komunitetit LGBTI. Në analizë të informacionit të marrë nga palët, vihet re se nuk ka qenë qëllimi i diskutimit të B.T, qëndrimi diskriminues ndaj komunitetit LGBTI, pasi jo vetëm gjatë zhvillimit të emisionit ka pohuar se është e hapur për të diskutuar mbi temën, por dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, është shprehur se *“do të donte që të ishte shmangur nga mënyra se si ishte zhvilluar debati”²²*.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, edhe pse mbi terma personale, debati ka patur shprehje jo etike nga të pranishmit, të cilat duhet të evitohen në të ardhmen, për të mos krijuar keqkuptime nga ana e publikut në përgjithësi dhe atij më pak të informuar në veçanti.

Në çështjen në shqyrtim, vlerësohet se, liria e mendimit i jep publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe për të formuar një mendim mbi idetë dhe qëndrimet e personave të ndryshëm, dhe si rrjedhim, liria e debatit është tamam në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se opinionet e B.T të shprehura gjatë emisionit “ABC e pasdites”, datë 08.06.2021, nuk kanë patur për qëllim që të nxisin urrejtje apo denigrim të komunitetit LGBTI, si dhe në asnjë rast nuk konsistojnë në shqetësim ose kërcënim ndaj këtij komuniteti. B.T ka shprehur një mendim personal, mbi një temë të caktuar, për të cilën ishte ftuar të diskutonte me pjesëmarrësit e tjerë, pa patur në thelb asnjë tendencë negative ndaj komunitetit LGBTI në tërësi. Komisioneri gjykon se gjuha e përdorur dhe qëllimi i saj nuk janë të atij niveli që të nxisin qëndrime diskriminuese apo veprime të dhunshme ndaj komunitetit LGBT.

²² Referuar seancës dëgjimore, min 24.20.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 3, 4, 7/1, nenin 20, 21/1, nenin 32/1/b), dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të ligjit 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “*orientimit seksual*”, të komunitetit LGBTI, të përfaqësuar nga Qendra “Të bashkuar Pro kauzës LGBT në Shqipëri”, nga ana e B.T.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA